



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM


PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.2.	PLUHURI DHE AGJENTËT KIMIKË
Nën-tema 2.2.3.	ASBESTI NË PUNË
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.07/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.04/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet që lidhen me kancerogjenët dhe mutagjenët në punë.
Shkurtesa:	• PPM – Pajisje Personale Mbrojtëse • MPA - Materiale që Përmbajnë Asbest • MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo”, bëni vërejtje për veprimet që do të ndërmerren për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNES			
	* Përgatituni për vizitën në lokacion. Nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme, udhëzimet për punën me asbest dhe kancerogjenë (p.sh. kuptimin e piktogrameve në etiketë, kërkesat për etiketim dhe paketim, rregullat), lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion. * Përgatitni një listë të plotë të inventarit të asbestit në kompaninë tuaj dhe informacionin për vendndodhjen, llojin, sasinë dhe rreziqet që paraqet. * Përgatitni një listë të plotë të të punësuarve që punojnë me asbest dhe që janë të ekspozuar faktikisht ose potencialisht.			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
	* Gjatë vizitës në lokacion / vendin e punës, kushtoni vëmendje nëse asbesti dhe materialet që përmbajnë asbest trajtohen, ruhen dhe asgjësohen siç duhet.			

	* Vëzhgoni procesin e asgjësimit të mbeturinave dhe sigurohuni që ndiqen procedurat standarde të operimit, përfshirë përdorimin e enëve ose qeseve të vulosura dhe të etiketuara qartë dhe dukshëm. * Kontrolloni nëse të punësuarit: ▪ përdorin PPM të përshtatshme; ▪ nuk pinë, hanë, apo pinë duhan në zonat e punës; ▪ janë pajisur me veshje mbrojtëse të përshtatshme ose veshje të tjera speciale të përshtatshme; ▪ janë pajisur me vende të ndara për ruajtjen e veshjeve të punës ose mbrojtëse dhe veshjeve normale; ▪ trajnohen për procedurat e sigurta të punës. * Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në varësi të kimikateve dhe faktorëve të riskut që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës! * Merrni shënime të vendeve të vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të vendeve ku përdoret dhe/ose ruhet asbesti dhe materialet që përmbajnë asbest. Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë. * Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësorë, shpjegoni dhe këshillojini ata për rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë me asbest. * Në fund, konsideroni fushat e mundshme për përmirësim.			
1.	A keni identifikuar praninë, vendndodhjen dhe sasinë e të gjithë materialeve që përmbajnë asbest në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 6, 7.2 * Kontrolloni që informacionet mbi etiketat të jenë në gjuhën që punëtorët e kuptojnë (Shqip dhe Serbisht). Identifikoni të gjitha vendet e punës ku përdoren ose përfshihen në struktura asbesti ose materiale që përmbajnë asbest (MPA), sigurohuni që ato janë etiketuar. Verifikoni informacionin e disponueshëm vizual për etiketat, krahasuar me kërkesat në Shtojcën e këtij dokumenti. * Shembuj të etiketave për substanca dhe përzierje kimike janë dhënë në shtojcën e kësaj liste kontrolli. Sigurohuni që materialet që përmbajnë asbest janë etiketuar si të tilla. Udhëzimet për etiketat janë dhënë në shtojcën në fund të kësaj liste kontrolluese.			

	<i>Bëni një listë të vendeve dhe materialeve që përmbajnë asbest dhe sigurohuni që lista të përditësohet rregullisht.</i>			
2.	A janë informuar të punësuarit për të gjitha materialet që përmbajnë asbest në zonat e tyre përkatëse të punës? A janë vendosur shenjat dhe etiketat që identifikojnë asbestin në mënyrë që të gjithë të punësuarit të dinë t'i shmangin këto materiale? Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 6, 7.2, 16.3 Pyetni të punësuarit tuaj: * A e dinë kuptimin e etiketave? * Nëse është bërë një listë e të gjitha materialeve që përmbajnë asbest në kompani dhe përmban ndonjë regjistrim, a mund të tregojnë të punësuarit se ku ndodhen këto materiale? <i>Shënim: Nëse ndërtesa në vendin e punës përmban asbest si material ndërtues ose izolues, të punësuarit duhet të dinë lokacionet dhe duhet të udhëzohen të mos i prekin këto materiale.</i>			
3.	Pirja e duhanit, ngrënia e çamçakëzit, dhe aplikimi i kozmetikës duhet të ndalohet në zonën e rregulluar. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 17.2.8 Vëzhgoni nëse: * të punësuarit pinë, hanë, pinë duhan ose aplikojnë kozmetikë në vendin e punës. * cigaret, paketimi i cigareve, shkrepsët, pakot e ushqimeve, ushqimi i papërfunduar ose gotat janë të dukshme në vendin e punës, kjo tregon që të punësuarit pinë dhe hanë dhe pinë duhan në vendin e punës.			
4.	Pirja e duhanit duhet të ndalohet në të gjitha zonat e punës. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 5 (Shtojca I), 8.3.4, 17.2 Pyesni të punësuarit nëse pinë duhan në zonën e punës. Nëse ata përgjigjen pozitivisht, trajnimi i tyre për sigurinë në punë ka qenë i pamjaftueshëm.			

5.	A janë punëtorët të pajisur me një dhomë të pastër dhe ambiente dushi të përshtatshme për punën që po kryhet, dhe a është ndaras zhveshtorja nga zona e ruajtjes ku ruhen veshjet dhe pajisjet potencialisht të kontaminuara? Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 5 (Shtojca I) <i>Kontrolloni planin hapësinor. Testoni të punësuarit a e dinë ku ruhen pajisjet e punës.</i>											
6.	A janë vendosur shenja paralajmëruese dhe të sigurisë në zonën ku përdoret asbesti? A janë lehtë të lexueshme? A janë shënjuar qartë zonat/detyrat e përcaktuara për përdorim të PPM-ve? Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 5 (Shtojca I), 8.3, 13.1 Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 <table><tr><td> Duhet të përdoren pajisjet e frymëmarrjes</td><td> Duhet të përdoren çizmet e sigurisë</td><td> Duhet të përdoren dorezat e sigurisë</td><td> Duhet të vishen veshjet mbrojtëse për tërë trupin</td></tr><tr><td> Ndalohet pirja e duhanit</td><td> Ndalohet hyrja për persona të paautorizuar</td><td> GHS08: Rrezik për shëndetin</td><td></td></tr></table>	 Duhet të përdoren pajisjet e frymëmarrjes	 Duhet të përdoren çizmet e sigurisë	 Duhet të përdoren dorezat e sigurisë	 Duhet të vishen veshjet mbrojtëse për tërë trupin	 Ndalohet pirja e duhanit	 Ndalohet hyrja për persona të paautorizuar	 GHS08: Rrezik për shëndetin				
 Duhet të përdoren pajisjet e frymëmarrjes	 Duhet të përdoren çizmet e sigurisë	 Duhet të përdoren dorezat e sigurisë	 Duhet të vishen veshjet mbrojtëse për tërë trupin									
 Ndalohet pirja e duhanit	 Ndalohet hyrja për persona të paautorizuar	 GHS08: Rrezik për shëndetin										
7.	Kontrolloni nëse është siguruar, testuar për përshtatje dhe përdorur pajisja e saktë personale mbrojtëse. Të punësuarit duhet të jenë të informuar/trajnuar pse duhet t'i përdorin PPM-të Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 13, 18											

	<i>Pyetni të punësuarit se cilat PPM duhet të përdorin, kur dhe pse (p.sh. kur dhe pse duhet të përdorin respirator, doreza dhe veshje mbrojtëse për tërë trupin). Shikoni nëse ata përgjigjen saktë.</i>			
8.	Puna në ndërtim me risk të lartë duhet të organizohet në atë mënyrë që të parandalojë shpërndarjen e fibrave të asbestit në mjedis. Për metodat e përshtatshme dhe dokumentet shoqëruese, shihni rregulloren më poshtë. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 7, 16 <i>Kabina sigurie në rast të aktiviteteve të demolimit:</i> 			
9.	Kërkoni nga të punësuarit t'i lajnë duart, fytyrën, parakrahët dhe qafën para çdo dalje nga zona e demarkuar dhe të bëjnë dush në fund të ditës. Sigurohuni që ata i ndjekin udhëzimet. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 7, 17.			


10.	Të punësuarve duhet të ju sigurohen veshje mbrojtëse për tërë trupin para se të hyjnë në zona të demarkuara. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 13, 18 <i>Verifikoni nëse të gjithë punëtorët në zonat e demarkuara janë të pajisur me veshje mbrojtëse për tërë trupin.</i>			
11.	A i zhveshin të punësuarit veshjet mbrojtëse kur largohen nga zonat e demarkuara? Në fund të ditës, a i vendosin ato veshje në një kontejner të padepërtueshëm për dekontaminim ose asgjësim? Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 13, 18			
12.	Duhet të ofrohen vende të ndara të ruajtjes për veshjet e punës ose mbrojtëse dhe për veshjet normale. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Nenet 13, 18 Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 11.1.3 <i>Vizitoni dhomën e zhveshjes së punëtorëve.</i>			
13.	Kontrollet inxhinierike duhet të përdoren për të zvogëluar ekspozimin ndaj asbestit të të punësuarve në nivelet më të ulëta të arritshme, dhe ventilimi lokal i shkarkimit duhet të projektohet, ndërtohet, instalohet dhe mirëmbahet. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, neni 8			
14.	Të gjitha pajisjet e dorës dhe makineritë që mund të prodhojnë ose lëshojnë fibra asbesti duhet të pajisen me ventilim lokal shkarkimi. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 8			
	<i>Kontrolloni nëse pajisjet e dorës dhe makineritë janë të pajisura me aspirator (nëse aplikohet).</i>			

15.	Duhet të merret një autorizim nga Autoriteti Kompetent për të punuar me materiale që përmbajnë asbest. Mbajtësi i licencës duhet të ketë sisteme të instaluara për dekontaminimin dhe mirëmbajtjen vjetore të pastruesve me vakum të asbestit të Klasit H. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 8 <i>Pastruesi me vakum i asbestit i Klasit H është mjeti kryesor për pastrimin pas punës me asbest.</i>			
INSPEKTIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË				
	* Takohuni me ekspertë të jashtëm ose të brendshëm për SSHP. * Shpjegoni vëzhgimet tuaja pozitive dhe negative nga vizita juaj në lokacion. * Në rast të vëzhgimeve negative, gjeni arsyen kryesore (p.sh. të punësuarit nuk e kuptojnë informacionin mbi etiketat e kimikateve) dhe bëni një plan veprimi për ta përmirësuar situatën. * Tregohuni miqësorë, sqaroni dhe këshillojini për detyrimet e tyre në lidhje me përdorimin dhe trajtimin e sigurt të kimikateve, organizoni trajnim të ri nëse ka nevojë.			
16.	A e mbani ju si punëdhënës licencën e saktë për punën që po ndërmerret? Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 15, Shtojca III <i>Punëdhënësi nuk duhet të ndërmarrë ndonjë punë me asbest, përveç nëse posedon një licencë të dhënë nga Autoriteti Kompetent.</i>			
17.	Të punësuarit duhet të trajnohen për punën me asbest dhe ACM. Ata duhet të kenë certifikata individuale të trajnimit të të punësuarve. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 15, (Shtojca III) 17 <i>Punëdhënësi duhet t'u ofrojë trajnim të punësuarve, posaçërisht në lidhje me pikat e përcaktuara në rregulloret në fuqi.</i> * Sigurohuni që keni Planin dhe Politikën e Trajnimit për të punësuarit që punojnë me materiale që përmbajnë asbest. Certifikatat individuale të trajnimit të të			

	<i>punësuarve duhet të tregojnë vendndodhjen, kohën, kohëzgjatjen dhe llojin e trajnimit të marrë dhe kush e ka ofruar trajnimin.</i>			
18.	Sigurohuni që është bërë vlerësimi i riskut. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 7 * Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse vlerësohen të gjitha proceset kimike teknologjike (p.sh., pastrimi, prerja etj.); * Kontrolloni a adresohet ekspozimi sipas rrugës së hyrjes në trup (p.sh., nga frymëmarrja, qëllitja, thithja përmes lëkurës). Të gjitha rrugët e ekspozimit duhet të merren parasysh, diskutoni me ekspertin për SSHP.			
18.	A e keni regjistruar numrin dhe emrat e të punësuarve potencialisht të ekspozuar ndaj asbestit? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 7 <i>Për shkak të vetive kancerogjene të asbestit, punëdhënësi duhet të ketë listën e të punësuarve të ekspozuar ndaj fibrave të asbestit.</i>			
26.	Organizoni matjen e fibrave të asbestit në ajrin e vendit të punës. Sigurohuni që të parandalohet ekspozimi i tepërt i të punësuarve ndaj asbestit (mbi 0.1 fibra për centimetër kub (ff/cm³) të ajrit në 8 orë, mesatarja e ponderuar në kohë (TWA)). Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 4 <i>Shihni raportin e testimit dhe vlerësoni rezultatet.</i>			
27.	Të punësuarit duhet të dërgohen në kontrole të detyrueshme shëndetësore në intervale të rregullta. Rregullore (MPMS) Nr.07/2017, Neni 19 Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 15			

	<i>Kontrolli fillestar mjekësor i të punësuarve duhet të bëhet dhe regjistrohet menjëherë pas punësimit. Kontrolli tjetër shëndetësor duhet të bëhet të paktën një herë në çdo (3) vjet.</i>			
	PAS VETËVLERËSIMIT			
	<i>* Diskutoni me menaxhmentin e lartë për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme Diskutoni me menaxherat e nivelit të mesëm të lokacionit/vendit të punës së vizituar për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësime.</i> <i>* Në rast se keni një ofrues të shërbimit të jashtëm të SSHP-së ose ekspert të SSHP-së, diskutoni me të për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësime.</i> <i>* Zbatoni masat e nevojshme të kontrollit të identifikuara gjatë vetëvlerësimit.</i>			

Shtojca

 The diagram shows a rectangular warning label with a total height of H mm and a width of 25 mm. The label is divided into three horizontal sections. The top section has a height of h mm (20 mm) and contains a large white 'a' on a black background. The middle section has a height of 30 mm and contains the text 'WARNING CONTAINS ASBESTOS' in bold, followed by 'Breathing asbestos dust is dangerous to health' and 'Follow safety instructions'. The bottom section is empty. Arrows indicate the dimensions and the placement of the text and the 'a' symbol. White 'a' on a black background Standard wording in white and/or black on a red background	Etiketimi i asbestit të papërpunuar, mbeturinave të asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest Dimensionet jepen në milimetra. Mund të përdoren madhësi më të mëdha, por raporti i h ndaj H në diagram do të mbetet 4 me 10 (40%). Etiketa duhet të jetë e shtypur qartë dhe e pashlyeshme, në mënyrë që të lexohen lehtësisht fjalët në gjysmën e poshtme të etiketës, dhe ato fjalë të shtypen në të zezë ose të bardhë.
---	---